



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

C-IV-14-4580

Parashtruese e ankesës; V V, rruga S V, N, Republika e Serbisë.

Kundër

Palës kundërshtare: Agjencia Kosovare e Privatizimit rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën:25.01.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

1. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga V V, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj vendimi me shkrim me numër GJI059-0616, i datës 14.04.2014, i lëshuar nga AKP.
2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 13.06.2014, pranë DHPGJS, është parashtruar ankesë nga V V, kundër palës kundërshtarë Agjencia Kosovare e Privatizimit në lidhje me vendimin me numër GJI059-0616, të lëshuar nga pala kundërshtare me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim e shumës prej 3,757.04 € në emër të kompensimit të pagave për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës, nga DP J-Gjilan (në likuidim).

Parashtruesja e ankesës ndër të tjera ka theksuar se pranë Autoriteti të Likuidimit ka parashtruar kërkesë për kompensim e shumës prej 3,757.04 €, në emër të kompensimit të pagave për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës dhe se Autoriteti i Likuidimit kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. Vendimin e Autoritetit të Likuidimit e ka kontestuar gabimisht faktet ngase ka qenë e punësuar në ndërmarrje me kohë të pa caktuar dhe se konstatimi i Autoritetit të Likuidimit se nuk ka qenë punëtor aktiv në ndërmarrje në kohën e privatizimit është i pa saktë.

Me tutje ka theksuar se asnjëherë nuk ka ardhur deri të ndërprerja formale e marrëdhënies së punës në ndërmarrje, dhe se për ndërprerje të marrëdhënies së punës është e nevojshme të ekzistoj një akt formal i ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Po ashtu ka theksuar se nuk ka pranuar rrogë nga ndërmarrja që nga muaji qershor i vitit 1999, dhe për këtë arsye nuk gjendet në listën e vitit 2006. Nuk ka mundur që të punoj në ndërmarrje nga qershori i vitit 1999, për arsye të njohura, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar ta aprovoj si të bazuar dhe të detyrohet pala kundërshtare që t'ia kompensoj shumën e specifikuar me lartë.

Kësaj ankese parashtruesja si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit me numër GJI 059-0616;*

Me datën 05.01.2022.2022, AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë ka paraqitur mbrojtjen ndaj kërkesës së parashtruar nga V V duke i propozuar gjykatës që ankesën e parashtruar ta refuzoj si të pa pranueshme, ose të pa bazuar dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Pala kundërshtare në mbrojtjen e parashtruar ndër të tjera ka theksuar se NSH J ka hyrë në procedurë të likuidimit me datën 19.08.2013. Parashtruesja e ankesës ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave në shumën prej 3,757.04 €. Autoriteti i Likuidimit ka nxjerrë vendimin me numër GJI059-0616, me të cilin kërkesën e parashtruar e ka refuzuar si të pa bazuar. Me tutje në mbrojtjen e parashtruar ka theksuar se pretendimet e dhëna nga parashtruesja e kërkesës janë të pa bazuara për faktin se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe drejtë i ka zbatuar edhe dispozitat ligjore. Neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034, mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit parasheh pagat e pa paguara si kërkesa prioritare dhe si të tilla kanë prioritet të lartë. Mirëpo ky nen nuk ua njeh të gjithë punëtorëve automatikisht të drejtën për tri paga. Kërkesat për paga të pa paguara duhet të mbështeten në prova që e vërtetojnë një detyrim të ndërmarrjes. Duke u bazuar në listën e pagave për muajin tetor të vitit 2006 të ndërmarrjes shoqërore përkatëse, Autoriteti i Likuidimit ka konstatuar se parashtruesja e ankesës para privatizimit të ndërmarrjes nuk ka qenë punëtor aktive në ndërmarrje. Përfundimisht i ka propozuar gjykatës që padinë e parashtruar ta refuzoj si të pa bazuar dhe ta vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit konform nenit 74.4 të Ligjit me numër 06/L-086.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore. Pas shqyrtimit të provave të lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar nga pala paditëse është e pa bazuar.

Në rastin konkret gjykata ka konstatuar se parashtruesja e kërkesës ka parashtruar pranë palës kundërshtare kërkesë për kompensim për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga parashtruesja e saj dhe me vendimin me numër GJI059-0616, kërkesën për kompensim për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës në shumën prej 3,757.04 €, e ka refuzuar si të pa bazuar ngase ka konstatuar se parashtruesja e kërkesës nuk ka qenë punëtoare aktiv në ndërmarrje në momentin e privatizimit.

Në lidhje me kërkesën për kompensim në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës gjykata potencon se kompensimi në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në ndërmarrje është e rregulluar në nenin 40 të Shtojcës së Ligjit për AKP, mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2, ku parasheh “kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në”. Nga këto dispozita është e përcaktuar se punëtori gëzon të drejtën për dëmshpërblim në tri paga “*Nëse punëtori ka qenë duke punuar në vendin e punës, kur Bordi i AKP-së, ka marr vendimin për fillimin e procedurës së likuidimit dhe nëse vërtetohet se punëtorit nuk ju janë paguar pagat*”.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundimin se parashtruesja e ankesës nuk ka parashtruar prova të cilat dëshmojnë se e njëjta ka qenë punëtoare aktive e ndërmarrjes në momentin e privatizimit të ndërmarrjes. Andaj nisur nga parimi i barrës së provës, në kuptim të dispozitës së nenit 322.1 të LPK-së, gjykata ka ardhur në përfundimin se parashtruesja e ankesës me provat e prezantuara nuk ka mundur që t’i argumentoj pretendimet e dhëna në ankesë, rrjedhimisht edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë do të heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi